

Përmbledhje Narrative e Analizës së Pyetësorit mbi Procesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Personat me Aftësi të Kufizuar, nga prindërit, familjarët dhe anëtarët e komunitetit

Përmbajtja

Përmbledhje	1
Gjetjet dhe rekomandimet	2
<i>Seksioni I: Informacione Demografike dhe Të Përgjithshëm për Pjesëmarrësit</i>	<i>2</i>
<i>Seksioni II: Përvoja me vlerësimin bio-psiko-social dhe sfidat e hasura</i>	<i>3</i>
<i>Seksioni III: Bashkëpunimi me anëtarët e komisioneve dhe institucione të ndryshme (shëndetësi, arsim, punësim)</i>	<i>5</i>
<i>Seksioni IV: Sfidat e hasura gjatë vlerësimit</i>	<i>6</i>
Analiza narrative	7
<i>Seksioni I: Informacione Demografike dhe Të Përgjithshëm për Pjesëmarrësit</i>	<i>7</i>
<i>Seksioni II: Përvoja me vlerësimin bio-psiko-social dhe sfidat e hasura</i>	<i>9</i>
<i>Seksioni III: Bashkëpunimi me anëtarët e komisioneve dhe institucione të ndryshme (shëndetësi, arsim, punësim)</i>	<i>17</i>
<i>Seksioni IV: Sfidat e hasura gjatë vlerësimit</i>	<i>19</i>

Përmbledhje

Ky raport përmbledh të dhënat e grumbulluara nga prindërit, familjarët dhe anëtarët e komunitetit në lidhje me përvojën e tyre me procesin e vlerësimit bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuar. Pjesëmarrësit ishin kryesisht femra (68%), duke reflektuar rolin më aktiv të grave në kujdes dhe mbështetje, ndërsa meshkujt përbënin 32%. Sa i përket moshës, grupi më i madh ishte 36–45 vjeç (40%), i ndjekur nga 46–55 vjeç (28%) dhe 26–35 vjeç (16%), ndërsa 18–25 vjeç dhe mbi 55 vjeç përfaqësoheshin me 4% dhe 8%. Roli kryesor i pjesëmarrësve ishte ai i prindërve (rreth 80%), ndërsa familjarët e tjerë dhe anëtarët e komunitetit përbënin nga 8% secili. Pjesëmarrësit jetonin pothuajse në mënyrë të balancuar në zona urbane (52%) dhe rurale (48%), duke nxjerrë në pah sfidat e aksesit në shërbime në zonat rurale.

Analiza tregon se shumica e pjesëmarrësve ishin aktivë gjatë procesit, por një pakicë mbetet jashtë tij për shkak të mungesës së informacionit ose pengesave për të aksesuar shërbimet. Komisionet e vlerësimit përbëhen kryesisht nga mjekë, ndërsa përfshirja e psikologëve dhe punonjësve socialë

shpesh mungon, duke rezultuar në vlerësime të pjesshme dhe shërbime jo të personalizuar. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve percepton ekipin profesional si të mirë, por mungesa e përbërjes multidisciplinare tregon nevojën për koordinim dhe monitorim më të mirë.

Pjesëmarrësit identifikojnë vështirësi si mungesa e informacionit, procedurat komplekse, vonesat dhe mungesa e mbështetjes emocionale. Rreth 70% ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja dhe se zëri i tyre nuk merret parasysh. Pakica ka marrë ndihmë direkte nga profesionistët, ndërsa shumica përballet me procesin pa mbështetje profesionale. Pritshmëritë e tyre lidhen me identifikimin e nevojave dhe sigurimin e mbështetjes konkrete për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa përvoja shpesh është e përzier: disa ndihen të kënaqur me angazhimin institucional, ndërsa të tjerët përjetojnë stres, lodhje dhe zhgënjim për shkak të komunikimit joefikas dhe mungesës së transparencës.

Si aspektet më problematike dallohen pjesët psikologjike dhe sociale të vlerësimit, mungesa e prezencës së psikologut dhe punonjësit social, terminologjia mjekësore e paqartë, mungesa e trajnimeve dhe e mjeteve të përshtatura, si dhe infrastruktura jo e përshtatshme.

Bashkëpunimi dhe komunikimi ndërinstitutional janë ende të kufizuar: vetëm 21% raportojnë bashkëpunim të plotë, 25% pjesërisht dhe 54% aspak. Komunikimi me institucionet për ofrimin e shërbimeve është i përzjerë: 38% e vlerësuan si të mirë, 21% të dobët dhe 42% pa komunikim. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe OJQ-ve shihet relativisht efektiv nga 46%, por 25% e konsideruan pak efektiv dhe 8% jo efektiv. Bashkëpunimi me komisionet e vlerësimit perceptohet shpesh negativ, me vetëm 20–25% pjesëmarrës që raportuan bashkëpunim të mirë.

Prindërit dhe komuniteti theksojnë nevojën për informim të qartë, përdorim të termave të kuptueshëm, shmangie të zvarritjeve, përfshirje më të ngushtë të profesionistëve (psikologë, logopedë, ekspertë të fushave të ndryshme), përmirësim të infrastrukturës dhe procedurave, mbështetje emocionale dhe trajnime për prindërit dhe fëmijët. Komunikimi ballë për ballë shihet si më efektiv, ndërsa materialet mbështetëse me shkrim mund të plotësojnë informacionin.

Në përgjithësi, procesi vlerësohet si i nevojshëm dhe përmban elemente të dobishme, por kërkon përmirësime në:

- komunikimin dhe përfshirjen aktive të familjeve,
- trajnimin dhe profesionalizimin e stafit,
- transparencën dhe koordinimin ndërinstitutional,
- adaptimin e infrastrukturës dhe mjeteve për zhvillimin e vlerësimeve.

Familjet shprehin shpresën që përmirësimi i procesit të kontribuojë në zhvillimin e normalizuar të fëmijëve, përfshirje më të barabartë në shoqëri dhe qasje më të mirë në shërbime gjithëpërfshirëse.

Gjetjet dhe rekomandimet

Seksioni I: Informacione Demografike dhe Të Përgjithshëm për Pjesëmarrësit

GJETJE

REKOMANDIME

1.1 Gjinia – Shumica e pjesëmarrësve janë femra (68%), ndërsa meshkujt janë vetëm 32%. Kjo tregon një mbizotërim të zërave femërorë dhe një përfaqësim të pamjaftueshëm të perspektivës mashkullore.	Rritja e përfshirjes së baballarëve dhe meshkujve të afërt për një perspektivë më të barabartë të kujdesit dhe nevojave.
1.2 Mosha – Grupi më i përfaqësuar është 36–45 vjeç (40%) dhe 46–55 vjeç (28%). Të rinjtë (18–25 vjeç) kanë pjesëmarrje minimale (4%), duke treguar mungesë të përfshirjes së brezit të ri në diskutime.	Zhvillimi i programeve dhe aktiviteteve për të rinjtë për të përfshirë perspektiva të reja dhe për të siguruar vazhdimësi në përfshirjen komunitare.
1.3 Roli i pjesëmarrësve – Prindërit mbajnë barrën kryesore (80%), ndërsa familjarët e tjerë dhe komuniteti përfaqësohen pak (16%), duke krijuar një fokus të ngushtë vetëm tek zëri i prindërve.	Forcimi i angazhimit të rrjetit familjar dhe komunitetit për të pasqyruar më mirë nevojat shoqërore dhe për të shmangur vendimmarrje të ngushta.
1.4 Pjesëmarrja sipas bashkive – Elbasani, Peqini dhe Librazhdi dominojnë pjesëmarrjen, ndërsa Cërriku, Përrenjasi dhe Gramshi janë shumë të nënfaqësuar. Kjo shkakton një pabarazi në përfaqësimin rajonal dhe mund të çojë në marrje vendimesh të pjesshme	Mobilizim i strukturuar i bashkive me pjesëmarrje të ulët për të siguruar një përfaqësim të barabartë rajonal.

Seksioni II: Përvoja me vlerësimin bio-psiko-social dhe sfidat e hasura

GJETJA	REKOMANDIMI
2.1 Shumica e pjesëmarrësve kanë përvojë me procesin e vlerësimit bio-psiko-social, por 20% nuk kanë pasur përvojë dhe mbeten jashtë procesit.	Të rritet ndërgjegjësimi dhe informacioni për familjet që nuk janë përfshirë, duke ofruar udhëzime dhe fushata informuese.
2.2 Komisionet janë kryesisht të përbëra nga mjekët, duke mos përfshirë psikologë dhe punonjës socialë.	Të sigurohet përbërje multidisiplinare e komisioneve për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj individëve me aftësi të kufizuara.
2.3 Shumica e pjesëmarrësve e konsiderojnë ekipin profesional dhe të organizuar, por mungesa e përbërjes së plotë multidisiplinare kufizon vlerësimin.	Të monitorohet dhe të sigurohet angazhimi i të gjithë profesionistëve të nevojshëm në proces.
2.4 92% e pjesëmarrësve e konsiderojnë procesin e vlerësimit bio-psiko-social të nevojshëm.	Të forcohet rëndësia e procesit për familjet dhe të rritet ndërgjegjësimi mbi përfitimet që ofron.

2.5 79% e pjesëmarrësve kanë pasur vështirësi për të kuptuar procedurat dhe hapat e vlerësimit.	Të ofrohen udhëzime të qarta, materiale informative dhe konsultime paraprake për familjet.
2.6 Problemet kryesore gjatë procesit janë: mungesa e informacionit (60%), procedurat e ndërlikuara (30–35%), mungesa e mbështetjes emocionale (25%), dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis institucioneve (15%).	Të përmirësohet komunikimi, të thjeshtohen procedurat dhe të ofrohet mbështetje emocionale për familjet.
2.7 Sfida gjatë përgatitjes për vlerësim: mungesa e informacionit (60%), vështirësi në komunikim (35%), dhe kohë e madhe për dokumentacion (10%).	Të përmirësohet qasja e informacionit dhe bashkëpunimi me profesionistët për të lehtësuar përgatitjen.
2.8 Vetëm 30% e pjesëmarrësve kanë marrë ndihmë nga profesionistët gjatë procesit.	Të sigurohet mbështetje aktive nga profesionistët për të gjithë pjesëmarrësit.
2.9 Pritshmëritë kryesore lidhen me identifikimin e nevojave të fëmijëve (64%) dhe marrjen e mbështetjes konkrete (36%).	Të lidhet procesi i vlerësimit më mirë me shërbimet dhe përfitimet për familjet.
2.10 68–70% ndihen se zëri i tyre nuk është marrë parasysh gjatë vlerësimit.	Të krijohen mekanizma për pjesëmarrje reale të prindërve dhe kujdestarëve në proces.
2.11 Përvoja e pjesëmarrësve është e përzier: 30–35% shumë të kënaqur, 25–30% mjaftueshëm të kënaqur, 35–40% pak të kënaqur.	Të përmirësohet organizimi, transparenca dhe komunikimi gjatë procesit.
2.12 Aspektet më të dobishme: vlerësimi mjekësor, terapitë jashtë orarit, evidentimi i pikave të forta/dobëta. Dobësitë: procedurat burokratike, mungesa e specializimeve, aktivitete të panevojshme.	Të thjeshtohen procedurat, të përmirësohet koordinimi dhe të sigurohen resurset specifike për fëmijët.
2.13 Vështirësi në komunikim me profesionistët: rreth 40% raportojnë probleme, 35–40% jo probleme.	Të përmirësohet mënyra e ndërveprimit me profesionistët për të rritur qartësinë, transparencën dhe besimin.
2.14. Ndjenja dominuese gjatë procesit: lodhje, pafuqishmëri, zhgënjim (50–55%), ndjenja pozitive 20–25%.	Të ofrohet mbështetje emocionale dhe qasje më empatike nga profesionistët.
2.15. Vështirësi kryesore në vlerësim: aspektet psikologjike dhe sociale (40–45%),	Të përmirësohet koordinimi multidisiplinar dhe qartësia në komunikim me familjet.

mjekësore/biologjike (25%), të gjitha aspektet (15–20%).

2.16 85–90% nuk kanë marrë trajnim specifik për vlerësimin bio-psiko-social.

Të ofrohen trajnime të strukturuar dhe të rregullta për të gjithë aktorët e procesit.

2.17 80% raportojnë mungesë të infrastrukturës dhe ambienteve të përshtatshme për vlerësim.

Të përmirësohet infrastruktura dhe ambientet për të siguruar një proces të barabartë dhe profesional.

2.18 65% raportojnë se profesionistët nuk përdorën gjuhë të veçanta ose mjete speciale; 20% po; 15% pjesërisht.

Të përdoren mjete dhe gjuhë të përshtatura për nevojat specifike të individëve.

Seksioni III: Bashkëpunimi me anëtarët e komisioneve dhe institucione të ndryshme (shëndetësi, arsim, punësim)

Gjetjet

3.1 Bashkëpunimi mes institucioneve (shëndetësi, arsimi, punësimi) është i kufizuar. Shumica thanë se nuk ka bashkëpunim ose vetëm pak.

3.2 Komunikimi me institucionet që japin shërbime është i përzjerë: disa e gjetën të mirë, disa të dobët, dhe shumë nuk kishin komunikim.

3.3 Bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave është i ndryshëm: disa thanë shumë efektiv, disa pak efektiv, disa jo efektiv.

3.4 Komunikimi me komisionet: disa thanë mirë, por shumë thanë të dobët, shumë të lodhshëm, ose aspak bashkëpunues

3.5 Ndhimja e komisioneve për të kuptuar se vlerësimi është më i gjerë (jo vetëm mjekësor) është e paqëndrueshme: disa ndihmohen, disa vetëm pak, disa aspak.

3.6 Qartësia e vlerësimit: 25–30% e konsideruan “i qartë” ose “shumë i qartë”, 35–40% “mjaftueshëm” ose “pjesërisht i saktë”, 25% “pak” ose “aspak i qartë”.

3.7 Mënyrat për përmirësimin e komunikimit: theksohen bashkëpunimi i ngushtë me

Rekomandimet

Të bëhet më shumë bashkëpunim mes institucioneve. Të ketë takime dhe rregulla të qarta për të punuar së bashku për personat me aftësi të kufizuara.

Të ketë më shumë informacion për prindërit dhe anëtarët e komunitetit, dhe stafi të trajnohet për të komunikuar më mirë.

Të bëhen partneritete më të mira dhe takime të rregullta për të ndarë informacion dhe përvojat e mira.

Stafi i komisioneve të jetë më profesional dhe miqësor, të japë informacion qartë dhe të ndihmojë prindërit dhe komunitetin të kuptojnë procesin.

Trajnime për komisionet që të shpjegojnë gjithë procesin dhe të ndihmojnë prindërit dhe anëtarët e komunitetit të kuptojnë vlerësimin.

Të bëhet më i qartë procesi i vlerësimit, me dokumente dhe udhëzime që prindërit dhe komuniteti mund t'i kuptojnë lehtë.

Të ketë më shumë takime, ndarje informacioni, trajnim për prindërit dhe

profesionistët, takime të shpeshta, mirëinformim, afrimet dhe trajnim i prindërve.

komunitetin dhe staf më miqësor dhe i afërt.

Seksioni IV: Sfidat e hasura gjatë vlerësimit

Seksioni	Gjetimet kryesore	Rekomandimet
4.1 – Si mund të përmirësohet procesi i vlerësimit bio-psiko-social?	Procesi nuk është gjithmonë i qartë dhe përdor terma të vështirë për prindërit. • Ka mungesë të profesionistëve të specializuar si psikologë, logopedë dhe ekspertë të fushave të ndryshme. • Komisioni shpesh merr vendime të shpejta pa dhënë shpjegime të detajuara. • Bashkëpunimi me prindërit dhe fëmijët është i pamjaftueshëm.	• Informim i qartë dhe i thjeshtë për prindërit dhe kujdestarët. • Përdorim i termave të kuptueshëm. • Shmangie e zvarritjes së panevojshme. • Përfshirje më shumë psikologësh, logopedësh dhe ekspertësh. • Komision më profesional dhe bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe fëmijët. • Trajnim i personelit dhe takime të rregullta me prindërit.
4.2 – Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara dhe e familjeve të tyre	• Mungon komunikimi i rregullt dhe i qartë mes institucioneve dhe familjeve. • Hapësirat aktuale nuk janë miqësore për fëmijët (zyra të mbushura me dosje). • Ka nevojë për aktivitete që matin progresin dhe ndryshimet tek fëmijët. • Nuk ka trajnime të mjaftueshme për prindërit dhe fëmijët.	• Takime dhe informim më të shpeshta mbi gjendjen e fëmijës. • Hapësira miqësore dhe funksionale për vlerësim. • Organizim i aktiviteteve dhe vlerësimeve që përshtaten me rastin individual. • Trajnime për prindërit dhe fëmijët. • Përfshirje e ekspertëve të specializuar dhe programe pune të përshtatura për familjet.
4.3 – Lloji i informacionit dhe mbështetjes gjatë dhe pas procesit	• Prindërit nuk marrin informacion të detajuar mbi progresin e fëmijës. • Mungon mbështetja emocionale dhe psikologjike. • Procedurat janë shpesh të paqarta dhe të ndërlikuara. • Familjet ndihen të lënë pas dore nga profesionistët.	• Informim i qartë mbi progresin dhe ndryshimet e fëmijës. • Udhëzime praktike për shërbimet dhe hapat që duhet ndjekur. • Mbështetje emocionale dhe psikologjike për familjet. • Procedura më të thjeshta dhe transparente.
4.4 – Institucionet dhe profesionistët që duhet të përfshihen më shumë	• Mungon përfshirja e logopedëve, psikologëve dhe mjekëve specialistë gjatë gjithë procesit. • Qendrat e terapisë, logopedisë dhe fizioterapisë nuk janë të angazhuara sa duhet. • Shërbimet sociale dhe bashkia nuk bashkëpunojnë në mënyrë aktive. • Komisioni i vlerësimit shihet si jo profesional dhe jo i ndjeshëm.	• Pjesëmarrje aktive e logopedëve, psikologëve dhe mjekëve specialistë. • Përfshirje më e madhe e qendrave të terapisë, logopedisë dhe fizioterapisë. • Bashkëpunim aktiv i shërbimeve sociale dhe bashkisë. • Trajnim i personelit për empati dhe profesionalizëm.

4.5 – Forma të përshtatshme të komunikimit	• Shumica preferojnë takime ballë për ballë për informacion dhe sqarime të drejtpërdrejta. • Një pjesë më e vogël përmend broshurat ose shpjegimet me shkrim si mbështetje shtesë.	• Prioritet takimeve ballë për ballë për pyetje dhe sqarime. • Broshura/shpjegime me shkrim si informacion mbështetës.
4.6 – Mesazhe për institucionet	• Kërkesë për staf dhe shërbime më të forta dhe më shumë orë terapie. • Profesionistë më të trajnuar dhe procedura më të lehta për prindërit. • Përmirësim i infrastrukturës dhe komunikimit me familjet.	• Forcim i stafit dhe shërbimeve. • Trajnime për personelin dhe përmirësim i infrastrukturës. • Procedura më të qarta dhe bashkëpunim më i ngushtë me arsimin dhe profesionistët.
4.7 – Shpresat dhe pritshmëritë për të ardhmen	• Dëshira për shërbime më cilësore dhe më afër familjeve. • Qartësi dhe mbështetje më e madhe për fëmijët. • Dëshira që fëmijët të zhvillohen normalisht dhe të përfshihen në mënyrë të barabartë në shoqëri. • Pritshmëri që vlerësimet të jenë të dobishme dhe të realizohen nga profesionistë të trajnuar.	• Përmirësim i cilësisë së shërbimeve dhe afërsisë së tyre. • Mbështetje e vazhdueshme për fëmijët dhe familjet. • Pjesëmarrje e ekspertëve të trajnuar për rezultate më të dobishme dhe gjithëpërfshirëse.

Analiza narrative


Seksioni I: Informacione Demografike dhe Të Përgjithshëm për Pjesëmarrësit

ANALIZA

1.1 Gjinia:

Pjesëmarrësit e fokus-grupeve ishin kryesisht **femra (68%)**, që përbëjnë rreth dy të tretat e totalit. Ky rezultat tregon një përfaqësim më të madh të grave, të cilat shpesh janë më aktive në çështje të kujdesit dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, si prindër ose të afërm. **Meshkujt (32%)** përbëjnë pak më shumë se një të tretën, duke siguruar një perspektivë gjithashtu të rëndësishme, por më të pakët në numër.

1.2 Moshë e pjesëmarrësve:



Nga të dhënat e mbledhura mbi moshën e pjesëmarrësve në fokus-grupe, vihet re se grupmosha më e përfaqësuar është ajo **36–45 vjeç**, me rreth **40% të totalit**. Ky rezultat tregon se në këtë proces kanë marrë pjesë kryesisht prindër dhe të afërm që ndodhen në moshën më aktive të kujdesit familjar dhe përgjegjësive prindërore.

Pas tyre, një përqindje e konsiderueshme prej rreth **28%** i përket grupmoshës **46–55 vjeç**, duke reflektuar përfshirjen e prindërve dhe kujdestarëve që kanë një eksperiencë më të gjatë në përballjen me sfidat e aftësisë së kufizuar. Grupi **26–35 vjeç** përfaqëson rreth **16%**, duke treguar një brez më të ri prindërish apo të afërmish, të cilët janë ende në fazat fillestare të kujdesit dhe përfshirjes aktive.

Gjithashtu, rreth **8% e pjesëmarrësve** i përkasin moshës **mbi 55 vjeç**, duke pasqyruar angazhimin e gjyshërve ose të afërmeve më të moshuar në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Ndërkohë, pjesëmarrja më e ulët është ajo e grupmoshës **18–25 vjeç**, me vetëm **4%**, që tregon se të rinjtë kanë qenë më pak të përfshirë në këto diskutime. **Kjo tregon se me këtë grupmoshë duhet të punohet më shumë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes aktive në çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar.**

Në përgjithësi, struktura e moshës së pjesëmarrësve pasqyron faktin se përgjegjësia për kujdesin dhe mbështetjen ndaj personave me aftësi të kufizuara bie kryesisht mbi prindërit në moshë të mesme, por gjithashtu ka edhe një kontribut të vlefshëm nga brezat më të rinj dhe më të moshuar.


1.3 Roli juaj:

Nga analiza e të dhënave mbi rolin e pjesëmarrësve në fokus-grupe, vihet re se përfaqësimi më i madh i takon **prindërve të personave me aftësi të kufizuara**, të cilët përbëjnë rreth **80% të totalit**. Ky rezultat është i pritshëm, pasi prindërit shpesh mbajnë barrën kryesore të kujdesit dhe përfaqësojnë zërin më aktiv në kërkimin e shërbimeve dhe të drejtave për fëmijët e tyre. Ky grup shfaq një angazhim të lartë, duke reflektuar nevojën e tyre të menjëhershme për mbështetje në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale për fëmijët e tyre që janë ende në proces zhvillimi dhe edukimi.

Ndërkohë, **familjarët e personave me aftësi të kufizuara** (si motra, vëllezër apo kujdestarë të afërt) përfaqësojnë rreth **12% të pjesëmarrësve**, duke treguar se edhe rrjeti i zgjeruar familjar është i përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces.


Një pjesë më e vogël, por e rëndësishme, është ajo e **anëtarëve të komunitetit**, me rreth **8%**, të cilët japin një perspektivë më të gjerë shoqërore dhe ofrojnë mbështetje nga jashtë strukturës familjare.

Ky shpërndarje tregon se procesi i fokus-grupeve ka arritur të mbledhë kryesisht zërin e prindërve, të cilët përbëjnë shumicën e pjesëmarrësve (rreth 80%), por gjithashtu ka përfshirë edhe perspektiva të tjera plotësuese nga familjarët dhe komuniteti. Kjo është një pasuri e rëndësishme për të kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara.



1.4 Pjesëmarrësit sipas bashkive

Rezultatet tregojnë se **Elbasani** zë peshën më të madhe me **25% të pjesëmarrësve**, duke reflektuar rolin e tij si qendër kryesore urbane dhe institucionale në rajon. **Peqini (20%)** dhe **Librazhdi (18.75%)** përbëjnë së bashku mbi 40% të pjesëmarrësve, duke treguar përfshirje aktive të komunitetit në këto zona. **Belshi (12.5%)** ka një nivel mesatar pjesëmarrjeje, ndërsa **Cërriku (8.75%)**, **Përrenjasi (7.5%)** dhe **Gramshi (7.5%)** paraqiten me përfaqësim më të ulët. Kjo shpërndarje thekson nevojën që në zonat me përqindje më të ulët të punohet më shumë me **ndërgjegjësim, informim dhe përfshirje të komunitetit**, në mënyrë që të sigurohet një balancë më e mirë në nivel rajonal.



1.5 Rezultatet sipas zonës së banimit

Pjesëmarrësit në fokus-grupe janë të shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis zonave urbane (52%) dhe rurale (48%). Kjo balancë tregon se procesi i mbledhjes së të dhënave ka arritur të përfshijë perspektiva nga të dyja llojet e komuniteteve, duke garantuar një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të situatës. Megjithatë, diferencat e vogla tregojnë se në zonat rurale mund të ekzistojnë më shumë sfida lidhur me aksesin në shërbime, informacion dhe mbështetje institucionale, gjë që e bën të domosdoshme një fokus të shtuar në këto komunitete.

Seksioni II: Përvoja me vlerësimin bio-psiko-social dhe sfidat e hasura

2.1 Rezultatet mbi përvojën me procesin e vlerësimit bio-psiko-social

Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve në fokus-grupe (80%) kanë pasur përvojë të drejtpërdrejtë me procesin e vlerësimit bio-psiko-social për fëmijën apo të afërmin e tyre me aftësi të kufizuara. Ky rezultat tregon se procesi është një praktikë e njohur dhe e përjetuar gjerësisht në komunitet. Megjithatë, 20% e pjesëmarrësve deklaruan se nuk kanë pasur kurrë një përvojë të tillë, çka sugjeron se ende ekziston një grup familjesh që mbeten jashtë këtij mekanizmi, për arsye të mundshme si mungesa e informacionit, burokracitë institucionale apo vështirësitë për të aksesuar shërbimet. Kjo nxjerr në pah nevojën për ndërgjegjësim më të madh dhe mbështetje të drejtuar posaçërisht ndaj këtyre familjeve, në mënyrë që askush të mos mbetet i përjashtuar nga procesi i vlerësimit.

2.2 Profesionistët që kane marre pjesë në procesin e vlerësimit


Nga të dhënat e mbledhura shihet se pjesa më e madhe e profesionistëve që kanë marrë pjesë në procesin e vlerësimit kanë qenë mjekët, të ndjekur nga kombinime të mjekëve, psikologëve dhe punonjësve socialë. Meqenëse vlerësimet në vendin tonë po realizohen gjithnjë e më shumë mbi bazën e modelit bio-psiko-social, komisioni i vlerësimit duhet të funksionojë si një strukturë multidisiplinare, duke përfshirë mjekë, psikologë dhe punonjës socialë, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj personit me aftësi të kufizuara. Mungesa e perspektivës psikologjike dhe sociale sjell pasojat të rëndësishme, pasi mund të çojë në vlerësime të pjesshme dhe në ofrimin e shërbimeve jo të personalizuara. Për të përmirësuar cilësinë e procesit, është e domosdoshme të sigurohet angazhimi i plotë i të gjithë profesionistëve të përcaktuar dhe të vendoset një monitorim i vazhdueshëm që komisionet të funksionojnë sipas standardeve të kërkuara.

2.3 Si e vlerësoni organizimin dhe profesionalizmin e ekipit që realizoi vlerësimin?


Sa i përket organizimit dhe profesionalizmit të ekipit që realizoi vlerësimin, shumica e pjesëmarrësve e konsiderojnë ekipin të mirë ose shumë të mirë: rreth 30% e vlerësuan si shumë i mirë, 50% si i mirë, ndërsa një pjesë më e vogël, rreth 20%, si i pranueshëm dhe vetëm një individ si shumë i dobët. Ky rezultat tregon një perceptim përgjithësisht pozitiv mbi profesionalizmin e ekipit, megjithatë, prania e vlerësimeve të pranueshme dhe dobëta sugjeron se ka ende hapësirë për përmirësim në koordinim dhe qasje profesionale. Po, duke pasur parasysh që komisioni nuk ka qenë i plotë sipas standardeve ligjore—dmth. nuk ka përfshirë të gjithë profesionistët e nevojshëm multidisiplinarë (mjek, psikolog, punonjës social etj.)—vlerësimi pozitiv i pjesëmarrësve merr një kuptim më relativ. Pavarësisht perceptimit pozitiv të shumicës (rreth 80% i mirë ose shumë i mirë), mungesa e përbërjes së plotë të komisionit sugjeron se disa nevoja dhe dimensionet e vlerësimit mund të mos jenë trajtuar si duhet. Kjo nënvizon nevojën për të siguruar që komisionet të funksionojnë sipas standardeve multidisiplinare, për të garantuar vlerësime gjithëpërfshirëse dhe të besueshme.

2.4 A e konsideroni procesin e vlerësimit bio-psiko-social si të nevojshëm?

Nga të dhënat e mbledhura, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve (rreth 92%) e konsiderojnë procesin e vlerësimit bio-psiko-social si të nevojshëm, ndërsa vetëm një pjesë shumë e vogël (rreth 8%) nuk e sheh të tillë. Ky rezultat tregon një ndërgjegjësim të lartë mbi rëndësinë e këtij procesi për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, duke reflektuar perceptimin se vlerësimi është një instrument i domosdoshëm për të identifikuar nevojat dhe për të garantuar shërbime adekuate dhe gjithëpërfshirëse.



2.5 A keni pasur vështirësi për të kuptuar procedurat dhe hapat që duhet të ndiqeshin?



Nga të dhënat e mbledhura, rreth 79% e pjesëmarrësve raportuan se kanë pasur vështirësi për të kuptuar procedurat dhe hapat që duhej të ndiqeshin gjatë procesit të vlerësimit bio-psiko-social, ndërsa vetëm rreth 21% deklaruan se nuk kanë pasur vështirësi. Ky rezultat tregon se një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve ka nevojë për udhëzime më të qarta dhe informacion më të detajuar mbi procesin, duke nënvizuar rëndësinë e transparencës dhe komunikimit më të mirë për të siguruar që të gjithë përfshirësit të jenë të informuar dhe të përfshirë plotësisht në vlerësim.

2.6 Problematikat e hasura gjatë procesit të vlerësimit?

Nga të dhënat e mbledhura, pjesëmarrësit raportuan një sërë problemesh gjatë procesit të vlerësimit bio-psiko-social, ku **mungesa e informacionit është problemi më i shpeshtë**, i përmendur nga rreth 60% e pjesëmarrësve. **Procedurat e ndërlikuara dhe vonesa në realizimin e vlerësimit** janë identifikuar gjithashtu si pengesa të shpeshta, duke ndikuar tek rreth 30–35% e pjesëmarrësve. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve (rreth 25%) raportoi **mungesë mbështetjeje emocionale**, ndërsa **mungesa e bashkëpunimit midis institucioneve** u evidentua nga një minorancë e pjesëmarrësve (rreth 15%). Një grup i vogël raportoi edhe probleme të tjera.

Ky rezultat tregon se, përtej profesionalizmit të ekipit, procesi ka sfida në aspektin **informues, procedural dhe mbështetës për familjet**, që mund të ndikojnë në përvojën e pjesëmarrësve dhe efektivitetin e vlerësimit. Përmirësimi i komunikimit, përshkrimi më i qartë i hapave dhe ofrimi i mbështetjes emocionale për familjet janë elementë të domosdoshëm për të garantuar një proces gjithëpërfshirës dhe të kuptueshëm.


2.7 Cilat janë sfidat më të mëdha që keni hasur gjatë përgatitjes për vlerësim?

Nga të dhënat e mbledhura, **mungesa e informacionit** rezulton të jetë sfida kryesore që përballët pjesëmarrësit gjatë përgatitjes për vlerësim, duke u përmendur nga rreth 60% e tyre. **Vështirësitë në komunikim me profesionistët** janë identifikuar gjithashtu si një pengesë e rëndësishme, duke prekur rreth 35% të pjesëmarrësve. Një pjesë më e vogël e pjesëmarrësve raportoi **kohë të nevojshme për të përfunduar dokumentacionin** si sfida (rreth 10%), ndërsa disa të tjerë përmendën edhe sfida të tjera të veçanta si: Mungesë mbështetjeje emocionale për familjet, Mungesë bashkëpunimi midis institucioneve. Vonesa në realizimin e vlerësimit, Procedura të ndërlikuara.

Ky rezultat tregon se, përveç sfidave gjatë procesit të vlerësimit, edhe faza e përgatitjes ka pengesa të dukshme, të lidhura kryesisht me mungesën e informacionit të qartë dhe vështirësitë në komunikim me profesionistët. Kjo nënvizon nevojën për përmirësim të udhëzimeve, qasjes së informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet familjeve dhe ekipit profesional për të lehtësuar procesin dhe për ta bërë atë më të qartë dhe efikas.

2.8 A keni pasur ndihmë nga profesionistët gjatë procesit?


Nga të dhënat e mbledhura, rreth 30% e pjesëmarrësve deklaruan se kanë marrë ndihmë nga profesionistët gjatë procesit të vlerësimit, ndërsa rreth 70% raportuan se nuk kanë marrë ndihmë. Kjo tregon se një pjesë e madhe e familjeve dhe personave me aftësi të kufizuara përballen me procesin pa mbështetje profesionale të drejtpërdrejtë, duke e bërë më të vështirë kuptimin dhe përmbushjen e procedurave të nevojshme për vlerësimin biopsiko-social.



2.9 Cilat janë pritshmëritë tuaja nga procesi i vlerësimit?

Nga analiza e përgjigjeve të pjesëmarrësve në fokus-grup, rezulton se pritshmëritë kryesore nga procesi i vlerësimit lidhen me **identifikimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara**, të cilin e kanë përmendur rreth **64% e të anketuarve**. Kjo tregon qartë se pjesa më e madhe e tyre e konsiderojnë procesin si një instrument thelbësor për të kuptuar dhe përcaktuar me saktësi nevojat individuale, duke synuar që këto të adresohen në mënyrë më të përshtatshme. Ndërkohë, rreth **36% e pjesëmarrësve** e shohin vlerësimin si një **mjet për të marrë mbështetje**, çka nënkupton se për ta rëndësi ka jo vetëm evidentimi i nevojave, por edhe lidhja konkrete e procesit me shërbimet dhe përfitimet që mund t'u ofrohen familjeve dhe individëve. Këto gjetje tregojnë se procesi i vlerësimit perceptohet njëkohësisht si **diagnostikues** dhe **pragmatik**, duke u parë si një hap i domosdoshëm si për të njohur situatën reale të personave me aftësi të kufizuara, ashtu edhe për të hapur rrugën drejt mbështetjes së nevojshme.

2.10 A keni ndjerë ndonjëherë që zëri juaj nuk është marrë parasysh gjatë vlerësimit?



Nga analizimi i përgjigjeve rezulton se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, rreth **68%**, kanë pohuar se **zëri i tyre nuk është marrë parasysh gjatë procesit të vlerësimit**. Vetëm **32%** e tyre janë shprehur se nuk e kanë pasur këtë ndjesi.

Ky rezultat tregon një boshllëk të dukshëm në funksionimin e procesit, pasi shumica e pjesëmarrësve ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja dhe nuk e shohin veten si palë aktive. Kjo sugjeron mungesë mekanizmesh efektive për të garantuar pjesëmarrjen reale të personave dhe familjeve të tyre, duke

rrezikuar që procesi i vlerësimit të mbetet formal dhe jo gjithëpërfshirës.


2.11 Nëse po, ju lutemi shpjegoni:

Nga komentet e dhëna nga pjesëmarrësit dallohet një shqetësim i thellë për **mungesën e dëgjimit aktiv dhe përfshirjes së tyre në procesin e vlerësimit**. Shumë prindër raportuan se ndihen të injoruar, pasi zëri i tyre nuk merret parasysh nga profesionistët, ndërkohë që ata kanë njohuri të drejtpërdrejta për gjendjen dhe nevojat e fëmijëve të tyre. Në disa raste, ata kanë përshkruar situata ku janë dhënë vetëm udhëzime të përgjithshme (“bëj vizita dhe shohim”), pa u ofruar shpjegime të qarta apo pa u kërkuar mendimi i tyre.

